



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR

TIRANË
Dhoma Penale

Nr.2180/81 S.P/586Regj.Themeltar

Nr.802

Vendimi

Dt.Regj.S.P./10.08.2021/17.01.2022 Regj.Them.

Dt. 28.03.2022

V E N D I M
“NE EMER TE REPUBLIKES”
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë
Gjyqtar Altin Abdiu

asistuar nga sekretare gjyqësore **Besarda Allaraj**, date 28.03.2022, përfundoi së shqyrtuari në seancë gjyqësore çështjen penale që u përket;

Prokuroria Prane Gjykates Se Rrethit Gjyqësor Tirane, me prokuror **Ardiano Dyrmishi**.

I pandehur: **Arben Nuriu**, i biri i Agako dhe Mibarime, dtl. 13.02.1965, lindur dhe banues ne Tirane, rruga “Shyqyri Bexolli”, shtepi private pa numer, shtetesi dhe kombesi shqiptar, me arsim te mesem, aktivitet privat, i denuar, me masen e sigurimit “detyrim per tu paraqitur ne policine gjyqësore”, ne mungese, i perfaqesuar me deklarim nga av. Ramiz Billa, Dhoma e Avokatise Tirane.

Akuzuar: Per kryerjen e veprave penale: “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” dhe “Korrupsioni aktiv ndaj personave qe ushtrojne funksione publike”, parashikuar perkatesisht nga nenet 291 dhe 244 pg.1 te Kodit Penal.

Objekti: Dergimin e çështjes ne gjyq.

Baza Ligjore: Neni 331 Kodi Procedures Penale.

Ne konkluzionet perfundimtare prokurori kerkoi:

- Deklarimin fajtor te te pandehurit Arben Nuriu per kryerjen e vepres penale “Drejtim automjeti ne menyre te parregullt” parashikuar nga neni 291 i K.Penal, denimin e tij me 3 (tre) muaj burgim.
- Deklarimin fajtor te te pandehurit Arben Nuriu per kryerjen e vepres penale “Korrupsion aktiv ndaj personave qe ushtrojne funksione publike” parashikuar nga neni 244 i K.Penal, denimin e tij me 9(nente) muaj burgim.
- Ne zbatim te nenit 55 të K. Penal, te pandehurit Arben Nuriu, i caktohet nje denim i vetem me 9 (nente) muaj burgim.

- Aplikimin e kërkesave të nenit 406 të K.Pr.Penale, uljen e 1/3 dhe denimin me 6 (gjashtë) muaj burgim.
- Zbatimin e nenit 59 të K.Penal, duke pezulluar pjesën e mbetur pa vuajtur të denimit me burgim dhe duke e vënë në provë të pandehurit për një afat 1 vjeçar.
- Kartmonedhat e sekuestruara të kalojnë në favor të shtetit.
- Shpenzimet proceduriale të ngarkohen të pandehurit.

-Avokati dhe i pandehuri paraqiten kërkesën për zhvillimin e gjykimt të shkurtuar dhe në konkluzionet përfundimtare kerkuan një denim sa më të butë, pezullimin e ekzekutimit të denimit me burgim, aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal.

-I pandehuri deklaroi se është dakord me avokaten përfundimisht i kerkoi Gjykatës meshire.

Gjykata pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VEREN

Prokuroria Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka paraqitur kërkesën për dërgimin në gjyq të çështjes penale ndaj të pandehurit Arben Nuriu, i akuzuar për kryerjen e veprave penale "Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt" parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal dhe "Korrupsion aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike", parashikuar nga neni 244 pg. 1 i K.Penal.

Nga shqyrtimi gjyqësor i çështjes, e cila është në juridiksionin dhe kompetencën e kësaj Gjykate, ka rezultuar se:

Më datë 13.07.2021 në orën 20:30, jemi njoftuar nga salla operative e Drejtorisë Vendore e Policisë Tiranë, se punonjësit të qarkullimit rrugor pranë Komisarariatit të Policisë Rrugore Tiranë kishin kapur në flagrancë shtetasin Arben Agako Nuriu, për veprat penale të "Korrupsion aktiv ndaj personave që ushtrojnë funksione publike" dhe "Drejtim i automjeteve në mënyrë të parregullt" të parashikuar nga nenet 244 dhe 291 të K.Penal.

Me datë 13.07.2021, shtetasi Ekledi Hysolli me detyrë punonjës i qarkullimit rrugor pranë Komisarariatit të Policisë Rrugore Tiranë, në Seksionin e Trafikut Urban ka qenë i planizuar trup shërbimi autopratullë turni i dytë (ora 14:00-22:00) me kod shërbimi 82/23 bashkë me kolegun e tij Olsi Leka ishin në patrullim në rrugën "Ana Komena", pranë shkollës së magjistraturës me mjet policie kur janë njoftuar nga shërbimi i Laprakës dhe nga 85/1 se një mjet Mercedes Benz CLS ngjyrë e zezë me targë AA534DI dyshohet se drejtuesi po drejton mjetin në gjëndje të dehur dhe ka marrë drejtim për tek ish fusha e aviacionit. Menjëherë kanë kaluar tek rrugica me emrin "Grigor Gjirokastriti" ku dhe kanë ndaluar mjetin. kanë kërkuar dokumentacionin e mjetit, patentën dhe dokumentacionin e mjetit dhe i kanë kërkuar që ti bëjnë një test drager. Drejtuesi i mjetit nuk pranonte ti frynte testit pasi sipas kallzuesit dukej se ishte në gjëndje të dehur. I kanë bërë të ditur që nëse nuk i frynte testit do të shoqërohet në komisariat. Më vonë drejtuesi i mjetit ka nxjerrë një kartëmonedhë 5000 lekëshe duke thënë merreni këtë për respekt. Në këtë moment i ka bërë të ditur që ky veprim nuk lejohet dhe për këtë arsye do të shoqërohej në drejtorinë e policisë. Kolegu i tij Olsi Leka ka shkuar përsëri për ti bërë testin e alkolit dhe prap zotëria nuk pranoi të bënte testin e alkolit duke i dhënë dhe Olsit një kartëmonedhë tjetër të prerës 5000 lekë të reja. Më pas erdhi patrulla dhe u bë shoqërimi i tij drejt Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë. Në ambjentet e Drejtorisë, drejtuesit të mjetit ju bë testi i dragerit ku rezultoi se testi i parë doli 0.87 mg/l dhe testi i dytë 0.86 mg/l. Drejtuesi i mjetit ishte shtetasi Arben Nuriu. Nga ana punonjësve të policisë rrugore është vënë masa administrative për shkeljen e nenit 144 pika 2, neni 170 pika I dhe 8 dhe neni 184 pika 2/c me pezullim leje drejtimi 20 muaj dhe -8 pike dhe me vlerë 25 000 leke të reja. Kane perpiluar procesverbalin e kapjes në flagrancë dhe raportin e

sherbimit. I pyetur ne cilesine e personit qe ka dijeni per rrethanat e hetimit, shtetasi Olsi Leka pohon theniet e kolegut te tij Ekledi Hysolli.

Nga ana e policise gjyqesore u sekustrua ne cilesine e proves materiale dy kartemonedha te prerjes 5000 (pese mije) leke te reja me numer serie NA7849784 dhe NB4107054. Ne perfundim te hetimeve prokurori ka konkluduar se i pandehuri Astrit Sadikaj, ka konsumuar ne kete menyre elementet e figures se veprave penale te "Korrupsion aktiv ndaj personave qe ushtrojne funksione publike" dhe "Drejtimit i automjeteve ne menyre te parregullt" te parashikuar nga nenet 244 dhe 291 te K.Penal.

Ekzistenca e faktit penale bazohet ne: Informacion per referimin e vepres penale; Procesverbal te kallezimit te vepres penale; Proceverbal i arrestimit te shtetasit Arben Nuriu; Procesverbal kqyrje marrje te proves material; Raport sherbimi; Procesverbal testimi alkolit mates me aparatin dragger.

Ne gjykim avokoati dhe i pandehuri ishin dakord me provat e te paraqitura nga prokurori dhe i kerkuar Gjykates te procedohet me gjykim te shkurtuar.

Perfaqesuesi i te pandehurit kerkoi nje denim sa me te bute, pezullimin e ekzekutimit te denimit me burgim dhe aplikimin e nenit 59 te Kodit Penal. I pandehuri shprehu qendrim pohues dhe pendues per veprimet e kundraligjshme te kryera.

Vleresimi i gjykates.

Gjykata, e bazuar ne nenet 331, 332/dh pg. 1 germa "c", 405 të K.Pr.Penale, per kete çeshtje çmon se, nuk jemi perpara rasteve te pavlefshmerise se kerkeses se prokurorise per dergimin e çeshtjes ne gjyq, te percaktuara ne nenin 331/2 te K.Pr.Penale. Nuk u konstatuan; akte te pavlefshme, prova te paperdorshme, nevoja per marrjen e provave te tjera. Veprimet hetimore te prokurorit jane kryer konform procedurave ligjore.

Meqenese çeshtja zgjidhjet ne gjendjen qe jane aktet dhe per shkak se nuk egziston rasti ndalues i percaktuar ne nenin 403/2 te K.Pr.Penale dhe ndonje nga rastet e percaktuara ne paragrafin 7 te ketij neni per mospranimin e gjykimit te shkurtuar, Gjykata ka vendosur pranimin e kerkeses te te pandehurit per zhvillimin e gjykimit të shkurtuar.

Në nenin 291 të K.Penal me titull "Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt", nder te tjera, është parashikuar se :

"Drejtimi i automjeteve apo mjeteve të tjera të motorizuara në gjendje të dehur, nën efektin e lëndëve narkotike, apo pa dëshminë përkatëse të aftësisë, dënohet me burgim nga dhjete dite deri në tre vjet".

Ndersa ne nenin 244 te K.Penal me titull "Korrupsioni aktiv i personave qe ushtrojne funksione publike", nder te tjera eshte parashikuar se:

"-Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt deri në vlerën 50.000 lekë ose ekuivalencën në monedhë të huaj personit që ushtron funksionin publik, për vete ose për persona të tjerë për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën ose funksionin e tij, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në një vit.

-Po kjo vepër, kur përfitimi i parregullt i personit që ushtron funksionin publik, për vete ose për persona të tjerë, është mbi vlerën 50.000 lekë, ose ekuivalencën në monedhë të huaj, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet."

Në këto kushte, bazuar ne aktet e fashikullit hetimor te shendrruara ne dosje gjyqesore per shkak te zhvillimit te gjykimit te shkurtuar, Gjykata krijon bindjen tej çdo dyshimi te arsyeshem se i pandehuri Arben Nuriu me veprimet e kundraligjshme te kryera, ka konsumuar plotësisht elementët e veprave penale "Drejtimi i automjeteve ne menyre te parregullt" parashikuar nga

neni 291 i Kodit Penal dhe “Korrupsioni aktiv i personave qe ushtrojne funksione publike”, parashikuar nga neni 244 pg. 1 i K.Penal.

- Objekt i ketyre veprave penale, janë marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për të siguruar veprimtarinë e rregullt të organeve të Policisë së Shtetit gjate ushtrimit te detyres, për të mos u ndikuar në kryerjen e detyrave dhe funksioneve publike nga veprimet korruptive, marrëdhënie keto të mbrojtura me legjislacionin penal nga veprimet apo mosveprimet kriminale si dhe për të garantuar qarkullimin e rregullt rrugor të drejtuesve te automjeteve, funksionimin e trafikut rrugor sipas ligjit, mbrojtjen e jetes dhe shendetit te individit.
- Nga ana objektive, veprat penale jane kryer nga i pandehuri nepermjet veprimeve aktive te kundraligjshme, i cili ka drejtuar nje automjet ne gjendje te dehur, u ka dhene dy punonjesve te policise nga 5000 mije leke me qellimin qe te mos zbatoheshin procedurat e testit te alkoolit me aparatin “Dragger”.
- I pandehuri eshte subjekt i veprave penale sepse, ka mbushur moshen per pergjegjesi penale dhe eshte i pergjegjshem perpara ligjit per veprimet e kundraligjshme te kryera.
- Nga ana subjektive veprat penale jane kryer me dashje direkte, me qellim perfitimi.

Në caktimin e llojit dhe të masës së dënimit, Gjykata ka parasysh:

Rrezikshmërinë relativisht të lartë shoqërore të veprave penale.

Rrezikshmërinë e paket shoqërore të të pandehurit, për të cilin rezulton se:

- i është caktuar mase sigurimi “detyrim per paraqitje”,
- është i denuar,
- ka shprehur pendim të thellë për veprat e kryera, fakt ky i parashikuar si rrethanë lehtësuese në nenin 48/ç të Kodit Penal.

Nisur nga rrezikshmëria shoqërore e vepres penale dhe e të pandehurit, shkalla e fajit, Gjykata çmon se i pandehuri duhet denuar me 9 (nente) muaj burgim per kryerjen e vepres penale “Drejtimit automjeti ne menyre te parregullt” bazuar ne nenin 291 te K.Penal. Gjithashtu ai duhet denuar me 9 (nente) muaj burgim per kryerjen e vepres penale “Korrupsioni aktiv ndaj personave qe ushtrojne funksione publike” bazuar ne nenin 244 pg. 1 te K.Penal. Ne zbatim të nenit 55 të K.Penal të pandehurit Arben Agako Nuriu i caktohet një denim i vetëm me 1(nje) vit e 6 (gjashte) muaj burgim.

Mbi këtë masë denimi duhet zbatuar kerkesat e nenit 406/1 te K.Pr.Penale, per shkak te zhvillimit te gjykimit te shkurtuar, duke i ulur te pandehurit 1/3 e denimit, i cili denohet me 1 (nje) vit burgim.

Per sa i përket kerkeses se prokurorit per pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim per te pandehurin.

Gjykata i referohet nenit 59 te K.Penal, me titull “Pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia në provë” në të cilin ndër të tjera është parashikuar se :

- “Për shkak të rrezikshmërisë së paket të personit, moshës, kushteve shëndetësore, ... dhe nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, ... si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale, Gjykata kur jep nje denim me burgim deri ne pesë vjet, mund të urdhërojë

që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të vihet në provë, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit...”.

Duke analizuar dispoziten e mesiperme, Gjykata çmon se i pandehuri i plotëson kushtet për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim, sepse :

- ka një rrezikshmëri të paket shoqërore,
- i është caktuar një masë dënimi me burgim nën pesë vjet.

Nga sa u arsyetua me sipër, Gjykata çmon se duhet pezulluar ekzekutimi i dënimit me burgim për të pandehurin Arben Nuriu.

I dënuari Arben Nuriu duhet të mbajë kontakte me Zyren Vendore e Shërbimit të Provës Tiranë dhe të vihet në provë për një afat 2 (dy) vjeçar me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë veprë tjetër penale.

Ne zbatim të nenit 60/9 të Kodit Penal, duhet të detyrohet i pandehuri Arben Nuriu që të mos shoqërohet me persona të denuar ose me precedente penale.

Meqenese i pandehuri rezultoi fajtor për veprat penale për të cilat akuzohet, në bazë të neneve 485 dhe 393 të K.Pr.Penale, ai duhet të ngarkohet me pagimin e shpenzimeve procedurale.

PER KETO ARSYE

Gjykata në zbatim dhe të neneve 379 - 384, 390 të K.Pr.Penale,

VENDOSI:

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit Arben Agako Nuriu për kryerjen e veprës penale “Drejtim automjeti në mënyrë të parregullt” bazuar në nenin 291 të K.Penal, dhe dënimin e tij me 9(nente) muaj burgim.

2. Deklarimin fajtor të të pandehurit Arben Agako Nuriu për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni aktiv ndaj personave që ushtrojnë funksione publike” bazuar në nenin 244 pg. 1 të K.Penal, dhe dënimin e tij me 9(nente) muaj burgim.

- Në zbatim të nenit 55 të K.Penal të pandehurit Arben Agako Nuriu i caktohet një dënim i vetëm me 1(nje) vit e 6 (gjashte) muaj burgim.
- Në zbatim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, të pandehurit Arben Agako Nuriu i ulet 1/3 e dënimit dhe denohet me 1 (nje) vit burgim.

- Bazuar në nenin 59 të K.Penal, të të pezullohet ekzekutimi i vendimit të dënimit me burgim për të pandehurin Arben Agako Nuriu.

- Urdhërohet i dënuari Arben Agako Nuriu të mbajë kontakte me Zyren Vendore të Shërbimit të Provës Tiranë dhe të vihet në provë për një afat 2 vjeçar me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë veprë tjetër penale. Afati i provës fillon nga e nesërmeja e shpalljes së këtij vendimi.

- Në zbatim të nenit 60/9 të Kodit Penal, detyrimin e të denuarit Arben Agako Nuriu, që të mos shoqërohet me persona të denuar ose me precedente penale.

- Provat materiale: dy cope kartmonedha të prerjes 5000 leke, të evidentuara në “Procesverbalin për sekuestrimin e sendeve” të datë 13.07.2021, bazuar në nenin 190/1 germa “a” të K.Pr.Penale, të kalojnë në favor të shtetit.

- Shpenzimet procedurale i ngarkohen të pandehurit.

- Kunder vendimit lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit Tirane brenda 15 ditësh duke filluar nga e nesërmeja e njoftimit të këtij vendimi.
- U shpall sot në datën 28.03.2022.

Sekretare
Besarda Allaraj

Gjyqtar
Altin Abdiu

Shpenzimet gjyqesore
Njoftime 2x150 lekë
Hetimet paraprake 2000 leke